



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI**

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_ / \_\_\_\_ / 2019

**V E N D I M**

**Nr. 5, Datë 08 / 01 / 2019**

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, bazuar në ligjin nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, mori në shqyrtim ankesën nr.116 Regj., datë 07.08.2018, e znj.E. H, kundër Filialit të Postës Shqiptare sh.a Berat, me pretendimin për diskriminim për shkak “*të bindjeve politike*<sup>1</sup>”.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

**K O N S T A T O I :**

**I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.**

Subjekti ankues, znj.E. H ka qenë në marrëdhënie pune me Zyrën Postare nr.1 Çorovodë, Skrapar nga data 05.02.2009 deri në datën 18.06.2018<sup>2</sup>, datë kur dhe i janë zgjidhur marrëdhëniet e punës. Ankuesja parashtron se nga ana e punëdhënësit nuk është njohur me asnjë shkak për largimin nga puna dhe ka bindjen se motivi i vërtetë i largimit të saj janë bindjet politike, pasi ajo është anëtare e forcës politike LSI. Ajo shprehet se pikërisht pas prishjes së koalicionit PS-LSI, në prill të 2017-ës asaj i është rritur presioni nga ana e Drejtorit të kësaj Zyre për shkak të anëtarësimit të saj në LSI. Znj.E. H shprehet se nga ana e drejtorit i është kërkuar të votojë për PS-në dhe se duhej të

<sup>1</sup> Referuar Kartës së Anëtarësisë së ankueses në partinë politike “Lëvizja Socialiste për Integrim” LSI, me nr.14020.

<sup>2</sup> Referuar të dhënave të Librezës së Punës së znj.E.H.

fotografonte votën e saj si provë. Në muajin Maj 2018, gjatë auditit të realizuar pranë Zyrës së Postës nr.1, Çorovodë, ajo shprehet se drejtori ka ushtruar presion mbi inspektorët e auditit në mënyrë që ata ta gjenin me shkelje. Znj.E. H shprehet se raporti auditit nuk ka konstatuar shkelje nga ana e saj dhe se largimi nga puna ka ardhur vetëm si rezultat i bindjeve të saj politike.

Në përfundim të ankesës së saj, znj.E. H kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi konstatimin e diskriminimit për shkak të bindjeve politike nga ana e punëdhënësit dhe shpërblim monetar.

## **II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.**

Në nenin 1 të ligjit nr. 10 221/2010, parashikohet objekti i këtij ligji, duke u sanksionuar se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Neni 7 i LMD-së<sup>3</sup>, në pikën 1 të tij, parashikon se: “Çdo veprim apo mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë apo privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta apo të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë apo grupe personash, përbën diskriminim”.

Bazuar në nenin 32/1/c të ligjit, Komisioneri ka kompetencë për të shqyrtuar shkeljet që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë në lidhje me këtë shkak.

**Përsa më lart, referuar nenit 33, të ligjit nr. 10 221/2010, ankesa përmban elementët e kërkuar nga ky ligj.**

Gjatë shqyrtimit të kësaj ankese, Komisioneri ka marrë në shqyrtim vetëm ato çështje, që bëjnë pjesë në kompetencat e tij, të parashikuara nga ligji nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32 dhe 33, të ligjit nr. 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

Ankesa e sjellë pranë Komisionerit kishte mangësi të anës formale, lidhur me shpjegimet e dhëna prej subjektit ankues.

---

<sup>3</sup>Shkurtesë për Ligjin për mbrojtjen nga diskriminimi.

1. Për këtë arsye, me shkresën me nr.1114/1 prot., datë 07.08.2018, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, i ka kërkuar ankueses të paraqesë dokumentacionin e nevojshëm për iniciimin e shqyrtimit të ankesës së saj.

Përsa më lart, ankuesja në vijim solli dokumentacionin e kërkuar, i cili ndodhet i depozituar në dosjen e saj pranë KMD-së<sup>4</sup>.

2. Me shkresën me nr.1114 prot., datë 31.08.2018, Komisioneri i ka kërkuar informacion Filialit të Postës Shqiptare sh.a Berat, lidhur me pretendimin e subjektit ankues.

Me shkresën me nr.999/1 prot., datë 28.09.2018 Filiali i Postës Shqiptare sh.a Berat, ka informuar Komisionerin se: *“Largimi nga puna i znj.E. Hka ardhur si rezultat i performancës së dobët dhe mosrealizimit të objektivave të degës së Postës Skrapar, ku ajo ishte drejtuese. Kjo Zyrë, referuar raportit të të ardhurave për këtë degë ka rezultuar me një rënie të ardhurash në shumën 35.141 lekë dhe një humbje nga muaji në muaj me 38.000 lekë<sup>5</sup>.”*

*Nisur nga ky fakt, me shkresën me nr.513 prot., datë 26.04.2018, Drejtori i Filialit të Postës Shqiptare sh.a Berat me Urdhërin nr.69, ka urdhëruar ngritjen e grupit të punës me objekt “Kontrollin e Degës Postare Skrapar”, për periudhën Dhjetor 2017-Prill 2018.*

*Grupi i punës pas kontrollit të bërë në këtë degë konstatoi një diferencë në arkë prej 199 lekësh. Znj.E. H ka refuzuar të firmosë akt-kontrollin përkatës.*

*Ndodhur në këto kushte, duke parë performancën e dobët dhe mosplotësimin e objektivave, si dhe mbështetur në raportet paraprake dhe ai përfundimtar i kryer nga Auditi i Brendshëm, janë konstatuar shkelje dhe parregullsi në kryerjen e detyrave funksionale nga ana e znj.E. H.”*

Në vijim të arsyetimit sa më sipër, Filiali i Postës Shqiptare sh.a Berat vlerëson si të drejtë largimin e znj.E. H nga puna duke mohuar që ky largim të ketë ardhur për motive politike.

3. Në vijim të procedurës së ndjekur për shqyrtimin e ankesës, me shkresën me nr.1114/5 prot., datë 10.10.2018, Komisioneri i kërkoi Filialit të Postës Shqiptare sh.a Berat informacion të specifikuar dhe dokumentacion provues, duke caktuar dhe një afat të arsyeshëm lidhur me kthimin e përgjigjes nga ana e tyre.
4. Meqenëse Filiali i Postës Shqiptare sh.a Berat nuk solli dokumentacionin e kërkuar brenda afatit të përcaktuar, inspektorët e KMD-së në zbatim të Urdhërit nr.197, datë 23.10.2018 të Komisionerit, realizuan një inspektim në ambjentet e këtij institucioni.

Grupi i inspektimit të KMD-së u takua me Përgjegjësin e Burimeve Njerëzore pranë Filialit të Postës Shqiptare sh.a Berat, i cili theksoi faktin se znj.E. H nuk është larguar për shkak të bindjeve politike, por vetëm për shkak se është gjetur me shkelje, me diferenca në arkë nga grupi i kontrollit. Ai citon se me bindje të LSI ka dhe punonjës të tjerë, të cilët vazhdojnë të jenë

<sup>4</sup> Referuar shkresës me nr.1114/2 prot., datë 13.08.2018.

<sup>5</sup> Referuar shkresës me nr.347/1 prot., datë 13.03.2018.

punonjës të këtij institucioni, të pashqetësuar për këtë fakt dhe bindjet politike nuk kanë shërbyer në asnjë moment si shkak për largimin e punonjësve nga puna. Ai kërkoi që t'i lihej një afat kohor për dërgimin e të gjithë materialit të kërkuar nga Komisioneri.

5. Mbështetur në nenin 33, pika 8, të ligjit nr.10 221/2010 "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi", për shqyrtimin e mëtejshëm të ankesës së znj.E. H, Komisioneri me datë 07.11.2018 realizoi një seancë dëgjimore<sup>6</sup>.

Seanca u zhvillua në mungesë të subjektit ankues dhe me praninë e përfaqësuesit me autorizim<sup>7</sup> të Filialit të Postës Shqiptare sh.a Berat, z.L.Sh.

Përfaqësuesi i Filialit të Postës Shqiptare sh.a Berat, në parashtrimet e veta lidhur me pretendimin e ankueses theksoi faktin se ajo është larguar nga puna vetëm si rezultat i shkeljeve që janë konstatuar dhe si rezultat i performancës së dobët në punë, pasqyruar kjo në rënien e të ardhurave të Zyrës që ajo drejtonte, pra të Zyrës Postare nr.1 Çorovodë. Ai solli në cilësi prove dhe kopje të dokumentacionit provues të bindjeve politike (LSI) të punonjësve të tjerë të cilët janë në marrëdhënie pune me Filialin e Postës Shqiptare sh.a Berat, duke mohuar që largimi nga puna bëhet mbi motivin e bindjeve politike. Gjatë seancës dëgjimore u depozituan në cilësi prove dokumentacion lidhur largimet nga puna të punonjësve, në raste analoge me subjektin ankues. (Fakte që janë marrë në konsideratë gjatë trajtimit të ankesës dhe që do të shtjellohen më poshtë në arsyetimin e vendimit)

Me shkresat me nr.1221 prot., datë 06.11.2018 dhe me nr.20/4 prot., datë 22.11.2018 Filiali i Postës Shqiptare sh.a Berat, ka dërguar një pjesë të dokumentacionit dhe parashtrime të tjera lidhur me pretendimin e subjektit ankues, duke theksuar se:

*“Bazuar në Urdhërin nr.69, datë 26.04.2018 të Drejtorit të Filialit Berat për kontrollin e befasishëm në Degën e Zyrës së Postës Skrapar është ngritur grupi i kontrollit i përbërë nga z.Dh.G, znj.M.C dhe znj.K.Ç. Në këtë Zyrë janë kontrolluar punonjëset M.E, E.K , P.L, E.Ll, dhe ankuesja, znj.E. H. Nga këto punonjëse 3 të parat rezultuan pa diferenca në arkë, ndërsa punonjësja e sportelit E.Ll rezultoi me një diferencë në arkë në shumën 30 lekë dhe ankuesja me një diferencë në arkë në shumën 92.324 lekë për të cilën ka debatuar me grupin e kontrollit. (znj.E. H ka firmosur personalisht procesverbalin e mbajtur). Znj.E. H i kryente vetë pothuajse të gjitha shërbimet dhe nuk lejonte sportelet e tjera të kryenin shërbime. Nga verifikimi i sistemit eterna rezultoi që kjo punonjëse nuk arkëtonte rregullisht shumat në financë, sipas “Rregullores së Postës” por një herë në muaj dhe gjendja në arkë prej 92.324 lekësh e fakton këtë. Libri i arkës nuk ishte i firmosur dhe për më tepër në sportel mbaheshin 2 libra arke, gjë që është një shkelje e rëndë e rregullores së kësaj kompanie. U konstatua gjithashtu se kishte dhe objekte të pa shpërndara që nga fillimi i muajit, të cilat punonjësja sipas rregullores duhet t'i kishte kthyer mbrapsht dhe nuk duhet t'i kishte në zyrë. Nga verifikimi i sistemit eterna me derdhjen në financë u konstatua se kishte mospërputhje për arkëtimet e gjobave nga data 01.04.2018-23.04.2018 në*

<sup>6</sup>Referuar shkresës nr.1512 prot., datë 31.10.2018, të Komisionerit.

<sup>7</sup>Referuar Autorizimit nr.1197 prot., datë 02.11.2018, të Filialit të Postës sh.a Berat.

*një shumë prej 52.746 lekësh ndërsa si arkëtime në financë ishin 46.346 lekë të arkëtuara. Pra, shuma e sistemit eterna dhe shuma e derdhur në financë rezultonte me një diferencë prej 6.400 lekësh.*

*Të gjitha këto shkelje të rënda të kryera prej saj, janë konstatuar si nga Auditi i Brendshëm i Drejtorisë së Përgjithshme, ashtu dhe nga kontrollet e ushtruara nga Drejtoria e Filialit Berat. Për këtë arsye ndaj saj është marrë masë për largimin e saj nga puna dhe jo për shkak të bindjeve të saj politike, siç pretendon ankuesja”.*

Lidhur me këtë fakt, Filiali i Postës Shqiptare sh.a Berat sqaroi se aktualisht pranë kësaj kompanie ka të punësuar punonjës me bindje politike të njëjta me ato të subjektit ankues, me anëtarësi në LSI dhe jo vetëm nuk janë hequr nga puna dhe vazhdojnë të punojnë të pa shqetësuar për këtë fakt, por dhe janë ngritur në detyrë. Kjo vjen për faktin se Posta Shqiptare sh.a është një shoqëri aksionere me vetëfinancim, të ardhurat e së cilës gjenerohn nga arkëtimet dhe performanca e çdo Filiali, pasi kjo Shoqëri nuk ka fond pagash të miratuar. Në vijim Filiali i Postës Shqiptare sh.a Berat thekson se punonjësit vlerësohen nga performanca e tyre, realizimi i planeve vjetore dhe objektive të kompanisë dhe jo nga bindjet politike personale. Lidhur me këtë kanë cituar emra konkretë punonjësish dhe kanë bashkëlidhur dokumentacionin përkatës për të provuar anëtarësinë e tyre në LSI, kështu:

- Punonjësja M.B (punonjësja që ka zëvendësuar ankuesen) mban pozicionin e Kryetarit të Zyrës Postare Çorovodë/Qendër.
- Punonjësi K.M aktualisht është punonjës me detyrën e Shefit të Sigurisë dhe Cilësisë.
- Punonjësi A.H aktualisht mban pozicionin e Kryetarit të Zyrës Postare Leshnje/Dega Skrapar.
- Punonjësi A.B aktualisht mban pozicionin e Kryetarit të Zyrës Postare Lapardha.
- Punonjësi I.M aktualisht mban pozicionin e Kryetarit të Zyrës Postare Gjerbës/Dega Skrapar.
- Punonjësja J.T aktualisht mban pozicionin e Kryetarit të Zyrës Postare Velabisht.

Nga ana tjetër, për të provuar faktin që ankuesja nuk është trajtuar në mënyrë të pafavorshme, për shkak të bindjeve politike të saj, Filiali i Postës Shqiptare sh.a Berat parashtroi se, po njëjto janë trajtuar (biles janë dërguar edhe për ndjekje penale për shpërdorim detyre) edhe punonjës të tjerë që janë anëtarë të forcës politike, PS. Kështu, punonjësi S.T, në pozicionin e Kryetarit të Zyrës Sinjë, pas ankesave të qytetarëve dhe verifikimit të tyre nga grupi i punës rezultoi me një diferencë monetare. Ndaj këtij punonjësi është depozituar një kallëzim penal nga ana e Filialit të Postës Shqiptare sh.a Berat, pavarësisht faktit se ai mban edhe postin e Kryetarit të subjektit politik PS, në fshatin Sinjë.

### **III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të administruara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.**

## **A. Lidhur me trajtimin e pabarabartë të ankueses nga ana e Filialit të Postës Shqiptare sh.a Berat.**

Mbështetur në aktet e administruara gjatë procesit të shqyrtimit të ankesës, rezulton se subjekti ankues, znj.E. H ka qenë në marrëdhënie pune me Zyrën Postare nr.1 Çorovodë, Skrapar nga data 05.02.2009 deri në datën 18.06.2018<sup>8</sup>, datë kur dhe i janë zgjidhur marrëdhëniet e punës. Referuar shpjegimeve të dhëna nga ana e Filialit të Postës Shqiptare sh.a Berat, largimi nga puna i znj.E. H ka ardhur si rezultat i performancës së dobët dhe mosrealizimit të objektivave të degës së Postës Skrapar, ku ajo ishte drejtuese. Kjo Zyrë, referuar raportit të të ardhurave për këtë degë ka rezultuar me një rënie të ardhurash në shumën 35.141 lekë dhe një humbje nga muaji në muaj me 38.000 lekë. Po ashtu, bazuar në Urdhërin nr.69, datë 26.04.2018 të Drejtorit të Filialit Berat për kontrollin e befasishëm në Degën e Zyrës së Postës Skrapar është ngritur grupi i kontrollit i përbërë nga z.Dh.G, znj.M.C dhe znj.K.Ç. Në këtë Zyrë janë kontrolluar punonjëset M.E, E.K , P.L, E.LI, dhe ankuesja, znj.E. H. Nga këto punonjëse 3(tri) të parat rezultuan pa diferencë në arkë, ndërsa punonjësjë e sportelit E.LI rezultoi me një diferencë në arkë në shumën 30 lekë dhe ankuesja me një diferencë në arkë në shumën 92.324 lekë për të cilën ka debatuar me grupin e kontrollit. Subjekti ankues është gjetur me shkelje si nga Auditi i Brendshëm i Drejtorisë së Përgjithshme, ashtu dhe nga kontrollat e ushtruara nga Drejtoria e Filialit Berat. Bazuar në këto kontrole është konstatuar se punonjësjë, znj.E. H i kryente vetë pothuajse të gjitha shërbimet dhe nuk lejonte sportelet e tjera të kryenin shërbime. Nga verifikimi i sistemit eterna rezultoi që kjo punonjëse nuk arkëtonte rregullisht shumat në financë, sipas “Rregullores së Postës” por një herë në muaj dhe gjendja në arkë e faktin këtë. Libri i arkës nuk ishte i firmosur dhe për më tepër në sportel mbaheshin 2 libra arke, gjë që është një shkelje e rëndë e rregullores së kësaj kompanie. U konstatua gjithashtu se kishte dhe objekte të pa shpërndara që nga fillimi i muajit, të cilat punonjësjë sipas rregullores duhet t’i kishte kthyer mbrapsht dhe nuk duhet t’i kishte në zyrë. Nga verifikimi i sistemit eterna me derdhjen në financë u konstatua se kishte mospërputhje për arkëtimet e gjobave nga data 01.04.2018-23.04.2018 në një shumë prej 52.746 lekësh ndërsa si arkëtime në financë ishin 46.346 lekë të arkëtuara. Pra, shuma e sistemit eterna dhe shuma e derdhur në financë rezultonte me një diferencë prej 6.400 lekësh.

Komisioneri përgjatë hapave proceduralë të ndjekur për hetimin e kësaj çështjeje, ka verifikuar procedurën e ndjekur nga ana e Filialit të Postës Shqiptare sh.a Berat, lidhur me trajtimin e punonjësjëve për të cilët ishin konstatuar shkelje të njëjta apo të ngjashme me ankuesen, si dhe masat respektive të ndërmarra prej tyre, për secilin rast.

Kështu, lidhur me pretendimin e Filialit të Postës Shqiptare sh.a Berat, se subjekti ankues është larguar nga puna për shkak të performancës së dobët reflektuar në rënie e të ardhurave për Zyrën Postare të cilën ajo drejtonte, Komisioneri verifikoi në mënyrë të hollësishme procedurën e ndjekur për çdo Zyrë të këtij Filiali si dhe të ardhurat e pasqyruara prej tyre.

Në përfundim të këtij verifikimi, Komisioneri vëren se:

---

<sup>8</sup> Referuar të dhënave të Librezës së Punës së znj.E. H.

Kryetarët e Zyrave Postare të cilat kanë rezultuar me rritje të të ardhurave dhe kanë ulur humbjen e tyre, vijnë në marrëdhënie pune. Konkretisht:

- Zyra Postare Çorovodë 2, me K/Z Postare znj.M. E rezulton me rritje të ardhurash 4.728 lekë.
- Zyra Postare Poliçan 1, me K/Z Postare znj.M. Z rezulton me rritje të ardhurash 2.944 lekë.
- Zyra Postare Çepan, me K/Z Postare z.A. H rezulton me rritje të ardhurash 2.012 lekë.
- Zyra Postare Potom, me K/Z Postare z.F. Ç rezulton me rritje të ardhurash 1.038 lekë.
- Zyra Postare Gjebez, me K/Z Postare z.I. M rezulton me rritje të ardhurash 80 lekë.
- Zyra Postare Konak, me K/Z Postare z.F. Sh rezulton me rritje të ardhurash 694 lekë.
- Zyra Postare Radesh, me K/Z Postare z.T. Sh rezulton me rritje të ardhurash 586 lekë.

Ndërsa, lidhur me mënyrën e trajtimit të K/Z Postare që kanë rezultuar me rënie të të ardhurave të zyrave të tyre, Komisioneri konstatoi se, K/Z Postare (ku përfshihet edhe ankuesja) bazuar në konstatimin e rënies të të ardhurave të këtyre zyrave (që çon dhe në humbje të të ardhurave) janë larguar nga puna. Konkretisht citojmë:

- Zyra Postare Çorovodë 1, me K/Z ankuesen znj.E. H ka rezultuar me rënie të të ardhurave 35.141 lekë.
- Zyra Postare Poliçan 2, me K/Z znjh.N. S ka rezultuar me rënie të të ardhurave 32.355 lekë.

Ndërsa citojmë se, disa punonjës të tjerë, K/Z Postare edhe pse janë konstatuar me rënie të të ardhurave të këtyre zyrave (që çon dhe në humbje të të ardhurave) nuk janë larguar nga puna dhe aktualisht janë në marrëdhënie pune. Konkretisht citojmë:

- Zyra Postare Bogovë, me K/Z z.A. Q ka rezultuar me rënie të të ardhurave 3.210 lekë.
- Zyra Postare Vendresh, me K/Z z.P. B ka rezultuar me rënie të të ardhurave 2.333 lekë.

Referuar sa më sipër, Komisioneri vëren se nga ana e Filialit të të Postës Shqiptare sh.a Berat, punonjësit sipërcituar nuk janë në të njëjtat kushte me ankuesen pasi, Zyra Postare që ajo derjtonte ka pësuar një rënie të të ardhurave 10-fish më të lartë se Zyra Postare Bogovë dhe Zyra Postare Vendresh; për pasojë ata nuk mund të trajtoheshin njëjloj. Në këto kushte, nga ana e Filialit të Postës Shqiptare sh.a Berat, nuk ka një trajtim të pafavorshëm të ankueses në krahasim me Kryetarët e Zytave Postare që janë mbajtur në punë, megjithëse zyrat që ata drejtojnë kanë rezultuar me rënie të të ardhurave, pasi është pikërisht entiteti i rënies së të ardhurave që ka përcaktuar dhe shkeljet më të rënda dhe më të lehta, duke sjellë dhe trajtime të ndryshme.

## **B. Shkaku i mbrojtur.**

Mbështetur në nenin 2<sup>9</sup> te ligjit nr. 10 221, date 04.02.2010 “Per mbrojtjen nga diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në ushtrimin e detyrës së tij siguron mbrojtjen efektive nga diskriminimi dhe çdo formë sjelljeje që nxit diskriminimin për një nga shkaqet që parashikon ky ligj. Ligji për mbrojtjen nga diskriminimi ndalon situatat kur persona ose grupe personash në një situatë të njëjtë trajtohen në mënyra të ndryshme, dhe situatat kur personat ose grupet e personave në situata të ndryshme trajtohen njësoj.

Gjithashtu, diskriminimi karakterizohet nga trajtimi i diferencuar, pra duhet të demonstrohet se subjekti ankues është trajtuar në mënyrë më pak të favorshme për shkak të një karakteristike që përfshihet në “shkakun e mbrojtur”. Trajtimi më pak i favorshëm përcaktohet me anë të krahasimit ndërmjet subjektit ankues dhe një personi tjetër në një situatë të ngjashme, i cili nuk posedon karakteristikën e mbrojtur, apo në krahasim me parashikimet ligjore, në kushtet kur mungon krahasuesi.

Bazuar në dokumentacionin që disponojmë nga hetimi, Komisioneri vlerëson se ankuesja mbart shkakun e pretenduar, atë të bindjes politike.

*“Bindjet politike”* përbëjnë shkak, për të cilin Ligji nr.10 221, datë 4.2.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, ofron mbrojtje. Në nenin 1 të tij përcaktohet se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”*.

Çështjet e diskriminimit kërkojnë që të vërtetohet nëse ekziston një përlligje e arsyeshme për trajtimin ndryshe të evidentuar.

Nga shqyrtimi i dokumenteve të administruara nga Komisioneri, rezulton se, znj.E. H është anëtare dhe aktiviste e subjektit politik “Lëvizja Socialiste për Integrim”, referuar dokumentit të anëtarësisë me nr.14020, datë 15.07.2016.

### **C. Lidhja e trajtimit të pafavorshëm me shkakun e mbrojtur.**

Filiali i Postës Shqiptare sh.a Berat, ka depozituar kopje të kartave të anëtarësisë në subjektin politik “Lëvizja Socialiste për Integrim”, të disa punonjësve të cilët vijojnë të jenë të punësuar pranë tyre. Konkretisht, citojmë:

---

<sup>9</sup> Neni 2: *“Qëllimi i këtij ligji është të sigurojë të drejtën e çdo personi për: a) barazi përpara ligjit dhe mbrojtje të barabartë nga ligji; b)barazi të shanseve dhe mundësive për të ushtruar të drejtat, për të gëzuar liritë dhe të marrë pjesë në jetën publike; c) mbrojtje efektive nga diskriminimi dhe nga cdo forme sjelljeje që nxit diskriminim.”*



- Punonjësi K. M aktualisht është punonjës me detyrë Shef i Sigurisë dhe Cilësisë pranë këtij filiali. Referuar listës shumë emërore për Këshillin Bashkiak Berat, ka qenë kandidat i subjektit politik LSI dhe vazhdon të jetë anëtar i kësaj force politike.
- Punonjësi A. H i punësuar që në vitin 2008 pranë këtij filiali është ngritur në detyrë gradualisht dhe mban pozicionin e K/Z Postare Leshnjë, dega Skrapar dhe është anëtar i subjektit politik LSI.
- Punonjësi A. B i punësuar që në 1993 pranë këtij filiali është u ngritur në detyrë gradualisht dhe mban pozicionin e K/Z Postare Lapardha, dhe është anëtar i subjektit politik LSI.
- Punonjësi I. M i punësuar që në vitin 2011 pranë këtij filiali është ngritur në detyrë gradualisht dhe mban pozicionin e K/Z Postare Gjerbës është anëtar i subjektit politik LSI.
- Punonjësja J. T e punësuar që në vitin 2007 pranë këtij filiali është ngritur në detyrë gradualisht dhe mban pozicionin e K/Z Postare Velabisht është anëtare e subjektit politik LSI.
- Punonjësja znj.M. B, e cila ka zëvendësuar aktualisht ankuesen në Zyrën Postare Çorovodë, është anëtare e subjektit politik LSI.

Referuar sa më sipër, nuk provohet se largimi nga puna i ankueses ka ardhur për shkak të bindjeve të saj politike. Kjo për faktin se dhe punonjësja që e ka zëvendësuar ka të njëjtat bindje politike me të, të dyja janë anëtare të forcës politike LSI. Po ashtu, pranë Filialit të Postës Shqiptare sh.a Berat provohet se ka dhe punonjës të tjerë që kanë bindje politike të njëjta me ankuesen, pasi janë anëtarë të subjektit politik LSI.

Komisioneri vlerëson se, subjekti ankues nuk i është nënshtruar trajtimit të pafavorshëm apo diskriminues nga ana e Filialit të Postës Shqiptare sh.a Berat, në raport me punonjësit e tjerë si dhe me punonjësën që e ka zëvendësuar atë konkretisht, për shkak të bindjeve të saj politike.

### **PËR KËTO ARSYE :**

Mbështetur në nenet 1, 3/1, neni 7/1, neni 12/1/c), nenin 32, pika 1/a, si dhe nenin 33, pika 10 të Ligjit Nr.10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

### **V E N D O S I :**

1. Konstatimin e mosdiskriminimit të znj.E. H nga ana e Filialit të të Postës Shqiptare sh.a

Berat, për shkak të bindjeve të saj politike.

2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në gjykatë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani, sipas parashikimeve ligjore të Kodit të Procedurave Administrative, të ndryshuar.

**KOMISIONERI**

**Robert GAJDA**

(shkaku: bindjet politike)

(fusha: punësim)